NOTERE
dot. Jelmira Veraj
VLORA

# A K T T H E M E L I M I
## E SHOQERISE ME PERGJEJESI TE KUFIZUAR " E D R O "

PULLE TAKSE 10 LEKE

### EMERTIMI,OBJEKTI I VEPRIMTARISE,SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA

Une Edmond Rexho i biri i Osmanit i datelindjes 9.9.1969,lindur e banues ne Vlore ortak i vetem i mbeshtetur ne ligjin 7638 dt.19.11.1992,konform kerkesave te tij vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuarte emertuar "EDRO" SH.P.K.

NENI 1

Shoqeria "EDRO" SH.P.K. do te kete seline e saj ne Portin e Vlores.Ajo mund te hapi zyra dege e perfaqesi e filjale ne tere territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 2

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte mbi 10 vjet.Ortaku i vetem ka te drejten e zgjatjes se ketij afati,si dhe uljen nen kete percaktim kohor.

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
Krijimi i agjensise detare dhe kryerje aktiviteti dhe veprimtarie ne kete agjensi.Kryerje te aktiviteteve tregetare spedicionere dhe spontues.Veprimtari te tjera tregetare si komisioner,konsulent profesional,kontraktues reklame,magazinues e shites me shumice dhe me pakice te te artikujve industrial, bujqesor,ushqimore,mallra te llojit makineri e pajisje,import e eksport i tyre.
Krijimi dhe funksionimi i agjensive te transportit te brendshem dhe nderkombetar,per trajtim mallrash dhe pasagjeresh.

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise "EDRO" eshte 100000 leke dhe shlyer 100 % nga ortaku i vetem z.Edmond Rexho.

NENI 5

Drejtimi i shoqerise "EDRO"SH.P.K. do te behet nga z.Edmond Rexho i cili do te jete dhe administratori i saj.

NENI 6

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.Administratori nxjerr bilancin i cili pasqyron aktivitetin financiar vjetor te shoqerise dhe ortaku i vetem vendos pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve dhe krijimit te fondit rezerve te shoqerise per fitimin e saj,per menyren e administrimit te tij.

NENI 7

Shoqeria per nevojat e veprimtarise se saj puneson punetore e nepunes duke respektuar te gjitha rregullat ne fuqi per punesim,Kodin e Punes,si dhe legjislacionin per sigurimet shoqerore.

NENI 8

Shperberja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfardo lloj shkaku ,si humbje e kapitalit te shoqerise,pamundesi veprimi,mbarim afati,ose me vendim te ortakut te vetem.
Ne keto raste ortaku i vetem vendos mbi menyrat e likujdimit,duke caktuar nje ose me shume likujdatore te cileve ju percakton dhe fuqite qe kane.
Ortaku i vetem i shoqerise perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 9

Rregullat e hollesishme per funksionimin e shoqerise jana percaktuar ne statutin e saj bashkengjitur ketij akti themelimi.

me 14.05.1996

ORTAKU I VETEM THEMELUES

EDMOND REXHO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA

Nr. 5599 rep.
Dt. 14-05-96

NOTERE
dot. Jetmira Veraj

VERTETIM

Sot me date 14/05/1996 perpara meja Noteres u paraqën personalisht Z.Edmond Rexho i dtl.1969,banues ne Vlore,L."Bashkimi" me zotesi te plote juridike te njohur personalisht prej meje ne baze te leternjoftimit qe me paraqiten,te cilet me deklaruan se sa siper eshte shkruajtur me vullnetin e tyre te lire.
Nenshkrimi i tyre u vertetua edhe nga une Noterja.

N O T E R E

NOTERE
dot. Jetmira Veraj
VLORA

# S T A T U T I

## *I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR*

## *" EDRO "*

### *NENI 1*

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EDRO" SH.P.K. eshte krijuar nga ortaku i vetem z.Edmond Rexho ne baze te ligjit "Per shoqerite Tregetare",pjeses se pare te kodit tregetar dhe ne pergjithesi te legjislacionit ne fuqi qe normon kete veprimtari.

Shoqeria ushtron aktivitetin dhe veprimtarine e saj ne baze te ekonomise te tregut te lire

### NENI 2

Ortaku i vetem Themelues i kesaj shoqerie,derdh kapitalin e tij ,me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria e saje,si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

### NENI 3

Shoqeria "EDRO" SH.P.K. eshte person juridik dhe giton zotesine per te vepruar ne regjistrimin e saje ne Gjykatene e rrethit Tirane dhe pajisen me çertifikaten e rregjistrimit nga Zyra e Tatimeve.

### NENI 4

Emertimi i shoqerise do te jete "EDRO" SH.P.K.

### NENI 5

Selia e shoqerise do te jete ne Vlore te Porti Detar.Ajo mund te hapi dege,perfaqesi e filiale ne tere territorin e Republikes te Shqiperise konform kerkesave qe parashikon ligji.

### NENI 6

Kohezgjatja e veprimtarise do te jete mbi 10 vjete.

### NENI 7

Objekti i shoqerise do te jete:

Krijimi i agjensise detare dhe kryerje aktiviteti dhe veprimtarie ne kete agjensi.Kryerje te aktiviteteve tregetare spedicionere dhe spontues.Veprimtari te tjera tregetare si komisioner,konsulent profesional,kontraktues reklame,magazinues e shites me shumice dhe me pakice te te artikujve industrial, bujqesor,ushqimore,mallra te llojit makineri e pajisje,import e eksport i tyre.

Krijimi dhe funksionimi i agjensive te transportit te brendshem dhe nderkombetar,per trajtim mallrash dhe pasagjeresh.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke.Ortaku i vetem Edmond Rexho e disponon kete shume baraz me 100 % ,te nenshkruar e te shlyer prej tij.

NENI 9

Kapitali mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise,me pelqimin e ortakut te vetem.Po me pelqimin e tij pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashgimie ose personave te tjere .Transferimet e kapitalit do te vertetohen me akt noterial.

NENI 10

Administratori i shoqerise do te jete z.Edmond Rexho.Ortaku i vetem ka per kopetence te caktoje si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk jane ortak.

Administratori ka per detyre ,organizimin dhe drejtimin e veprimtarise.Ai kryen te gjitha veprimet e administrimit ne intereste saj.

Ne marrdheniet me te tretet ai angazhon shoqerine ndermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori humbet detyren e tij ne rast te prishjes te shoqerise dhe kur eshte i zgjedhur ,kur shkarkohet nga ortaku themelues.

NENI 11

Kompetencat e zakonshme dhe te jashtezakonshme sipas ligjit "Per shoqerite tregetare",i ushtron teresisht ortaku i vetem themelues Edmond Rexho.

NENI 12

Shoqeria "EDRO" SH.P.K.mund te lidhi kontrata me sektor shteteror drejteperdrejt ne tregun e lire si dhe me persona juridik e fizik vendas e te huaj.

NENI 13

Ne veprimtarine kontraktuale te saj Shoqeria parfaqsohet nga administratori i saj z.Edmon Rexho ose persona te tjere te autorizuar prej tij.Te drejtat e detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 14

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal,afatet e derdhjes te tij,sigurimet shoqerore etj.Ajo ka te drejta te çeli llogari likujduese prane Bankave te vendit dhe te huaja dhe te kryeje veprime likujduese ndermjet tyre.

NENI 15

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne leke dhe ne valute te huaj.Shkembimin e monedhave shqiptare me te huajadhe anasjelltas,mund te beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Bangat Shqiptareose ne tregun e lire privat te valutes.

NENI 16

Per pasqyrimin e aktivitetit privat,administratori ose persona te tjere te caktuar prej tij jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas ligjit.

NENI 17

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin dhjetor te çdo viti.Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilanc vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe ti depozitojne ato ne organin financiar te juridiksionit perkates.

NENI 18

Ortaku themelues vendos per shtimin e ortakeve si dhe personave te tjere qe do te punesohen ne shoqeri.

NENI 19

Marrdheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin. Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhensi ne librin e punes te shoqerise,si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionitku ushtron aktivitet shoqeria.

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti te leshuar nga administratori duke u zbatuar kerkesat e Kodit te Punes.

Largimi i te punesuarit nga shoqeria,behet pasi te jene shlyer detyrimet materiale dhe monetare te tij.

NENI 20

Shoqeria mund te marre truall per ndertim ose me qirasi dhe objekte te ndryshme ne pronesi duke perpiluar kontratat perkatese

NENI 21

Pas shlyerjes se detyrimeve fiskale,detyrimeve te tjera ndaj shtetit,sigurimeve shoqerore dhe çdo detyrimi tjeter,fitimi ngelet ne pronesi te ortakut te vetem Z.Edmond Rexho

NENI 22

Shperberja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfardo lloj shkaku ,si humbje e kapitalit te shoqerise,pamundesi veprimi ose me vendim te ortakut te vetem.